



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 90/2017

Prishtinë, më 14.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha- Shala, Blerim Grainca dhe Rustem Berisha, anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Rexhepi, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Halit Hoxhaj, Nazimi Zenelaj dhe Burim Hashani – MZHE; Petrit Pepaj ZRRE; Dardan Abazi – INDEP; Blerta Aliu – KDI; Etleva Malushaj – LVV; Marigona Zhubi – GLSP; Jeta Rafuan, Sami Salihu dhe Arianit Berisha – GPLDK; Albulena Mavaraj- Epoka e Re; Edona Kurteshi –Koha Ditore; dhe Kaltrina Rexhepi – BIRN.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 7.3.2017;
3. Raporti i Post Privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike – KKDFE (KEDS);
4. Shqyrtimi i Raportit për Rekomandime të Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
5. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7.3.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7.3.2017, u miratua pa vërejtje.

Kryetari, propozoi konkluzion nga debati lidhur me problemin e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, ku kërkohet nga Ministreja për dialog, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe nga KOSTT-i që të përgatiten masat të cilat do t'i marrin nëse kjo çështje nuk zgjidhet shpejt, me të cilat do t'i përgjigjeshim dëmeve që i shkakton Serbia në anëtarësimin e KOSTT-it.

Komisioni e aprovoi propozimin e kryetarit.

3. Raporti i Post Privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike – KKDFE (KEDS)

Kryetari, theksoi se në një mbledhje të kaluar kemi marrë qëndrim që të kërkojmë një raport nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik, Komiteti Qeveritar për Post-Privatizim dhe Zyra e Rregullatorit për Energji lidhur me Post-privatizimin e KEDS-it. Ne e kemi pranuar një raport nga keto institucione për këtë çështje, i kemi të ftuar përfaqësuesit e këtyre institucioneve që të na njoftojnë për procesin dhe ecurinë e Post Privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike – KKDFE (KEDS) dhe fjalën i'a kaloi përfaqësuesit të MZHE-së për të paraqitur raportin në fjalë.

Halit Hoxhaj, këshilltar i lartë politik – Ministria e Zhvillimit Ekonomik, së pari kërkoj falje për mos prezencën e ministrit sot në këtë takim e dyta ne kemi dorëzuar një raport me shkrim të cilin ju e keni këtë, bashkë me mua sot janë këtu sekretari i ministrisë zotëri Zenelaj dhe udhëheqësi i njesisë së postprivatizimit zotëri Hashani. Meqënëse kemi të bëjmë me një raport që është përpiluar në koordinim me këshilltarët e transaksionit dhe monitoruesit poashtu në procesin e privatizimit nga ISC-ja unë në pika të shkurtëra mund ti përshkruaj elementet kyqe të këtij raporti ia jap fjalën udhëheqësit të njesisë së postprivatizimit zotëri Hashanit.

Burim Hashani - MZHE/NSPP, njësia ka vazhdu monitorimin në emër të komunitetit qeveritar të privatizimit d.m.th me vendim të qeverisë komuniteti qeveritar ka vazhdu monitorimin në mënyrë që të sigurohen objektivat të cilat edhe janë dëshiruar në procesin e privatizimit. Kontratat kyqe që janë të nënshkruara në mes qeverisë dhe KEDS-it janë marrëveshja për shitblerjen e aksioneve dhe marrëveshja për implementim, marrëveshja për implementim i përmban të gjitha obligimet e palëve pas privatizimit ku janë disa elemente aty. Mirëpo si tri pikat kyqe që janë cilësu që monitorohen më shumë ka qenë obligimi për shthurrjen ndërmjet divizionit distribucionit dhe furnizimit sepse janë privatizu dy divizionet ajo ka qenë e kërkueme edhe me ligjin për energji elektrike edhe me direktiva të EU-së kjo është kry me 31 dhjetor 2014 d.m.th në bazë të udhëzimeve të ZRRE-së. Pikë tjetër që e kemi monitoru vazhdimisht kanë qenë të

drejtat e punëtorëve të transferum ku janë garantu kontratat për 3 vite mund të themi që deri 3 vite nuk është largu asnjë puntëtor, ka pas largime vullnetare numrat i keni në raportin përpara dhe të pensionuar, më pas disa kontrata nuk janë vazhdu dhe KEDS-i vazhdon të ketë obligime me ligj, me ligje të Kosovës, ligjin vazhdon ta respektoj. Sa i përket investimeve neni 4.14 thotë që KEDS-i duhet të investoj 300 milionë mbrenda 15 viteve gjithnjë me aprovimin e këtyre të hyrave të lejuara nga ZRRE-ja. Ne do t'i monitorojmë si shumë totale pasi që me plan zhvillimor të gjitha aprovoen dhe monitorohen nga ZRRE që i bie 200 milionë në vit në bashkëpunim edhe me ZRRE-në ne jemi të kënaqur, ecuria e investimeve është duke shkuar në rregull d.m.th edhe janë duke u tejkaluar numrat për vitin 2016 investimet kanë qenë 23 milionë. Në përgjithësi edhe këshilltarët ne jemi mbështet nga këshilltari i transakcionit ISC-ja në fazën postprivatizim këtë e kanë bërë duke e ditur rëndësin e monitorimit postprivatizim. ISC-ja ka shpenzuar mbi 600 mijë dollarë në donacione të veta për të na e mbështetur njesinë dhe në bazë të ISC-së privatizimi është ndoshta më i suksesshmi në rajon i cili prej fillimit kanë fillu rezultatet pozitive ata e kanë bërë një analizi për benifitet për përfitimet nga privatizimi për 3 vitet e para por duke i marr parasysh parametrat si largimi i subvencioneve nga buxheti i shtetit që nga koha e privatizimit, rritja e inkasimit, rritja e taksave të paguara për shtet ku hyn edhe taksa për thëngjillë, zvogëlimi i mjenezhershëm i qmimit të importeve prej 30% të gjitha këto kanë ndikuar që përfitimet financiare si në buxhet si në tarifa të jenë 150 milionë euro për 3 vitet e para kjo është me analizë të ISC-së.

Petrit Pepaj Zyra e Rregullatorit për Energji, në fjalën e tij theksoi se parametrat rregullativ janë vendos qysh në vitin 2012 që ka të bëjë me planin e investimeve 2012-2017 dhe në atë plan të investimeve d.m.th janë parapa se sa do të ketë investime operatori i sistemit të shpërndarjes për vite, është parapa niveli i lejuar i humbjeve se sa do të jetë për 5 vite, është përcaktuar edhe një faktor i efikasitetit për të cilin në 3 vitet e para ka qenë 0 ndërsa në vitin e katërt është marr 5% ky do të jetë faktorë i efikasitetit në nivelin e shpenzimeve operative. Ne e kemi bërë një monitorim edhe atë raportin e monitorimit veq e kemi dorëzuar tek ju. Rrjedhja e investimeve kapitale d.m.th është kjo në vitin 2013 kanë qenë të lejuara 21 milionë kurse janë realizuar 16 milionë, në vitin 2014 kanë qenë 21 milionë janë realizuar 17 milionë në vitin 2015 kanë qenë të lejuara 21 milionë janë realizu 20 milionë ndërsa në vitin 2016 janë të lejuara 21 milionë ndërsa janë realizuar 23.6 milionë d.m.th ky është viti që ka qenë vit i investimeve. Ne kemi kërkuar gjatë bisedave që i kemi pas me ata se ku qëndrojnë problemet në realizmin e investimeve ata na kanë shpreh disa probleme që i kanë me komunat gjatë dhënies së lejeve në realizimin e investimeve për të cilat ata kanë probleme dhe kanë pengesa dhe si rrjedhojë e këtyre mos dhënieve nëpër komuna ku ata dëshirojnë të investojnë dhe kjo ka qenë pengesë në investime, çdo gjë që nuk është realizuar kthehet prap te konsumatori pra nuk do të lejojmë asnjë përfitim kompanisë së distribucionit sa i përket mos realizmit të investimeve kapitale ndërsa sa i përket nivelit të humbjeve kur janë vendos parametrat ZRRE ka lejuar me qenë në 27.4% dhe qdo 3 vitet e para me pas zvogëlim për 3 % ndërsa në 2 vitet e fundit me pas 4.5%, fatkeqësisht KEDS-i në kohën kur është privatizuar ka trashëguar edhe një nivel të humbjeve 1.8% që ka qenë e trashëguar prej KEK-ut edhe ajo e ka përcjellë gjatë gjithë kohës edhe deri më sot kështu që çdo nivel i cili përtej caktit që është i përcaktuar nga ZRRE d.m.th ka qenë penallti për KEDS-in d.m.th konsumatorët nuk kanë paguar për mos realizmin e humbjeve. Ndërsa është edhe një hubje që e kemi në pjesën veriore që d.m.th kanë jashtë autoritetit të operatorit të sistemit të shpërndarjes ndërsa sa i përket importit dhe eksportit në vitin 2013 janë realizuar 23 milionë import, ne vitin 2014 janë realizuar 45.5 milionë ka qenë viti kur ka ndodh edhe aksidenti i Kosovës A ku është

një rritje pak më shumë për me mujt me i mbuluar nevojat e konsumatorëve, në vitin 2015 janë 35.4 milionë, ndërsa në vitin 2016 janë 21.6 milionë janë të realizuar dhe të gjitha këto do të reflektohen edhe në raportin vjetor i cili do të ju dërgohet në fund të muajit. Ndërsa sa i përket nivelit të operimeve gjatë raportit të monitorimit ne kemi has disa parregullësi të cilat janë të përshkruara në raport edhe për të cilat e përgaditë një njoftim për menagjmentin e KEDS-it dhe i kemi cek të gjitha ato mospërputhje që janë në raport me obligimet që dalin gjatë punës, ju kemi dhënë afat 30 ditë kohë për me i përgaditë përgjigjet edhe planet se si do ti realizojnë këto përmisime ne jemi në pritje të përgjigjeve nga KEDS-i. Në vazhdimësi do ti monitorojmë edhe në vazhdimësi do ta mbajmë komisionin të njoftuar për qfardo parregullësi që ka ose ne gjatë punës së përditshme me operatorët jo vetëm me KEDS-in por edhe me KOSTT-in, KEK-un edhe operatorë të tjerë që janë të licensuar. E kemi vërejt që ka pas ngecje në nivelin e shpenzimeve operative sidomos të mirëmbajtjes ia kemi tërheq vërejtjen në mënyrë të theksuar që niveli që është i parapar edhe është i përcaktuar në tarifa për nivelin e shpenzimeve operative duhet të realizohet përndryshe niveli i cilësisë së shërbimeve bjen nëse nuk bëhen investimet në mënyrë urgjente në mirëmbajtjen e planifikuar dhe të lejuar në tarifat që paguan konsumatori.

Raif Qela, theksoi se jemi më mirë me furnizim me energji se sa që kemi qenë disa vite më parë. Privatizimi sa do që për shumë kë i diskutueshëm megjithatë i ka dhënë disa rezultate, ka furnizim më të mirë me energji elektrike, ka më pak nevojë për subvencionet nga institucionet dhe vet fakti flet që rreth 150 milion për 3 vitet e para janë përfitime siq u deklarua nga njëri prej parafolësve tregon njëfar shenje që gjendja është më mirë se që ka qenë por se edhe me vet faktin që edhe prej vet raportit të monitorimit që e ka bërë ZRRE-ja janë disa prej këtyre konstatimeve të cilat do ti them më vonë. Është dasht të jet mbikëqyrja më e madhe e zbatimit të kontratës respektivisht dinamikës së realizimit të investimeve. Thuhet se rezultat i vonësive në implementimin e projekteve kapitale dhe mos realizimin e mirëmbajtjes sipas nivelit të lejuar nga ZRRE-ja meqëse mos realizimi i investimeve kapitale për vitet 2013 – 2014 nuk është realizuar në vitet në vijim ose nuk ka arritur ta kompenzojë mos realizimin e investimeve të mbetura në vitet e cekura më lartë. Ju i përmendët se në vitet përkatëse 2013-2016 ka qenë 16, 17 dhe respektivisht 23.6 milionë euro nga të paraparat për qdo vit nga 21 milionë kjo tregon se ritmi i investimeve nuk është ai që është dashur të jetë, a ka pasur penalizim për operatorin përderisa nuk i ka realizuar investimet, a ka pasur arsye për ato që i ka thënë apo vetëm justifikime siq e thatë ju se nuk ka marr leje nga komunat e tjera, a ka pasur mundësi që ato investime ti bëjë në fushë tjetër, pse nuk i ka bërë në fushë tjetër prej asaj që ka synuar ti bëjë dhe sa do të ndikojë kjo në qmimin e energjisë elektrike në qoftëse konstatohet se p.sh ka humbje në rrjet apo qkado qoftë e cila manifestohen në qmimin të cilin konsumatori e paguan. Konsatatimi i fundit i vetë raportit thotë përkundër nevojës së madhe për riparime dhe mirëmbajtje të rrjetit të shpërndarjes për shkak të gjendjes egzistuese KEDS-i nuk e ka realizuar nivelin e duhur të operimit të mirëmbajtjes si rezultat i ulët i nivelit të këtyre shpenzimeve nuk është arritur përmisimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike në nivelin e kërkuar. Këto konstatime të juajat janë dhe si të tilla flasin mjaftë që ju megjithatë po e mbikëqyrni aq sa keni mundësi. Cilët janë mekanizmat që ju ta ndëshkoni operatorin nëse nuk i përmbahet kontratës, a keni ndërmar ndonjë hap të tillë, a ka pasur nevojë për ndërmarje sepse ju jeni ata që duhet ta përcaktoni këtë. Pastaj shpesh ka ndërprerje të energjisë elektrike, po ndodh shpesh si rastësi që pikërisht në kohën kur po ka nevojë të importohet rrymë elektrike po ka edhe kinse planifikime për qoftë ndërhyrje të planifikuara apo ndërhyrje paplanifikim për shak të ndonjë defekti etj, pse po ka kaq shumë rastësi në këtë qështje a jeni ju mjaft duke e mbikëqyr këtë qështje apo është dashur që të ndërhyhet ndonjë herë, se kur

ka pas ndërhy kryetari edhe ka kërkuar raport prej jush në mënyrë që të shihet se a ka pasur disa lëshime në këtë çështje.

Blerim Grainca, theksoi se po e trajtojmë një temë mjaft aktuale edhe një temë që ka zgjuar interesim që nga filimi i procesit të privatizimit deri tek efektet e privatizimit dhe rezultatet që po i shohim sot megjithatë të gjithë pajtohemi se privatizimi ska pas alternativë tjetër dhe ka qenë proces mëse i domosdoshëm. Nga raporti i ZRRE-së shihet një numër i caktuar i aktiviteteve gjegjësisht i obligimeve që nuk janë përmbush nga operatori. Kolegu Raifi i përmendi disa duke fillu prej investimeve kapitale, dhe kërkesave që i ka bërë operatori megjithatë një dukuri që po na përcjell jo vetëm tek zyra e rregullatorit por te shumica e këtyre bordeve është se efektet apo mundësit për me i kontrollu, edhe ligji parasheh që ju e mbikëqyrni por pjesa pastaj prej mbikëqyrjes e deri tek futja në funksion e obligimeve ne nuk jemi për me i ndëshku bizneset por do të duhej ta forëconi më shumë këtë pjesën që i obligon ata për me iu përmbajt kontratës. Problemet aktuale të cilat më shumë po e prekin qytetarin ju po i shihni qdo ditë, një prej atyre unë që e kam has kohëve të fundit ka qenë këto shkyqjet kolektive p.sh zona të tëra, fshatëra shkyqen pa ndonjë paralajmërim të caktuar me një arsyetim banal kinse 2 apo 3 banorë të asaj lagje nuk kanë paguar rrymë pastaj pason një ndëshkim kolektiv, a keni marr masa që kjo të mos ndodh ose p.sh në zona të thella rurale mund të ndodh me ditë të tëra nuk ka energji edhe arsyetimi është se po bëhen punime, nuk mund të bëhen punime në 7 qendra njëkohësisht këto kanë qenë edhe arsyetime publike që i kemi ndëgjuar prej kompanisë më herët, a kanë qenë të sakta këto nga monitorimi i juaj, a janë bërë punimet në të njëjtën kohë, a ka qenë kjo arsyeja, a lidhen këto shkyqje të rrymës pastaj me importin që e përmendi Raifi, edhe ajo që e kisha kërku është më qenë më konkret në masat që keni edhe me na informu ne si deputet.

Glauk Konjufca, tha se po flasim për një temë shumë të rëndësishme për vendin tonë sepse ka të bëjë me një vendim i cili është realizuar në vitin 2013 nga qeveria e kaluar për privatizimin e pjesës së distribucionit të KEDS-it më saktësisht edhe kjo ka ngritë disa dilema edhe ka pas një debat të madh shoqëror. Më kujohet në atë kohë por problemi kryesor egziston në mënyrën që qeveritë i zgjedhin për të i bërë privatizimet edhe më kujtohet që në atë kohë e pata lexu një studim të një autori i cili merret me këto privatizimet problematike në Evropën Juglindore sidomos privatizimet që ndodhin në shtetet që ende nuk e kanë sistemin e konsoliduar të demokracisë edhe të kontrollit shtetëror edhe aty thuhet që kryesisht qeveritë të cilat kanë interesa të ngushta dominohen prej interesave të disa klaneve të caktuara ku demokracia nuk është e konsoliduar ata zgjedhin disa privatizime të këtijë lloji siq është ky i KEDS-it, po du me thënë që zgjedhin disa privatizime që qmimin e kanë shumë të vogël në kontrat por krejt fokusin e kanë te investimet që do të vinë pastaj e që janë shumë d.m.th është ë vërtet është shit shumë lirë gati fal është dhënë ajo far pune 26 milionë euro e 300 milionë euro do të vinë pastaj e do të na përmissohet sistemi do të na mbetet e gatshme. Pastaj kjo ka qenë mënyra edhe logjika që po më kujtohet por kjo është njëfar truku i disa qeverive që asetet me i dhënë gati fal e investimet kurr nuk ndodhin ashtu si premtohen edhe shumë më e lehtë është për një shtet si Mali i Zi me i marr 400 mijë euro menjëher e pastaj i investon ku të don edhe si të don e krijon një fond p.sh të zhvillimit me ato para e Kosova me 26 milionë euro i merr edhe nuk i sheh hiq e më pastaj nuk i sheh as këto të tjerat që janë 300 milionë kjo është e para. E dyta mua po më interson qeveria cili është ai institucion që i vlerëson investimet e sakta sepse problemi im është se kur thuhet 80 milionë euro i ka investuar KEDS-i prej se ka ardhur këto absolutisht nuk janë vreytur p.sh në aspektin e funksionimit teknik të ndërprejes të energjisë elektrike se ne po jetojmë në Prishtinë e energjinë

elektrike po më duket se po e shiqojmë prej Prishtinës por energjia elektrike duhet shikohet prej Malishevës edhe prej Shtimës në Kosovë e edhe prej shumë komunave të tjera ku prej orës 12 të ditës kemi reduktime. E prej humbjeve teknike të cilat ne mund ti themi shifra por humbjet teknike edhe vet ekspertat thonë se nuk ka pas ndonjë ndryshim të dukshëm të humbjeve teknike edhe këtu egziston një dyshim të theksuar që edhe vet ky raport kur po e lexojë ne nuk kemi kriju ende kulturë të mbrojtjes së interesit publik këtu në Kosovë. Ky raport është i shkruar sikur të jetë i shkruar nga menaxhmenti i KEDS-it e jo i shkruar nga qeveria e Kosovës, qeveria e Kosovës është palë ajo e shtyn interesin e vetë edhe kur të privatizohet një aset qeveria e shtyn përpara interesin e vetë edhe privatizuesi e shtyn përpara interesin e vetë edhe ato pikëprehen dikund, kur e lexon është krejtësisht e njëanshme d.m.th asnjë problem nuk përmendet vetëm suksese kurse problemet janë evidente. Pastaj kjo e punëtorëve këtu nuk ka dal ashtu siq ka premtu ai që e ka blerë për arsye se tash ne po sjellim këtu edhe atë rrëfimin e punëtorëve e jo që ne po i referohemi vetëm KEDS-it sepse punëtorët janë edhe grup i organizuar i interesit të cilët i kanë institucionet e veta edhe e shpjegojnë këtë punë edhe rrëfimi i punëtorëve nuk po përputhet me rrëfimin e KEDS-it d.m.th ka largime të paligjshme nga puna nuk mund të i mbyllim sytë edhe të themi adresa e atyre që përjetojnë padrejtësira është gjykata e tek ne dihet se sa kohë shkon deri tek një vendim deri në 2-3 vite. Sa i përket qështjeve sikur që ka qenë problematika e orave e kjo sepse regjistrimi i takon KEDS-it e poashtu vendosja e orave të reja ka qenë problem në Kosovë e që ka 2 vite që nuk e kam dëgjuar që është përmendur as që është ndëjk prej prokuroirsë pra u paraqit sikur problem që është zgjidhur por unë nuk besoj që është zgjidhur si problem edhe krejt ekspertat e fushës ku edhe ne këtu si deputet informohemi nga disa informacione që i marrim nga njerëzit që pretendojnë që e njohin më mirë këtë fushë e ata pretendojnë që vetëm 4000 mijë ora të cilët e regjistrojnë energjinë elektrike e fryn shpenzimin e energjisë elektrike e vetëm 4000 ora janë vendosur në Kosovë edhe tash KEDS-i e ka paraqitur këtë si një problem që është kry. Pra ka pas një defekt i kemi zbulu orat që e fryn energjinë elektrike dhe me kaq u përmbyll kjo punë e jo nuk është ashtu sepse a e dini se qfarë rritje të energjisë elektrike ka në Kosovë nuk e ke në rajon të njejtën masë të rritjes së energjisë elektrike qysh ka qenë në Kosovë, e nëse faktura ekuivalente e 2012 në Kosovë janë ardh 50 euro e sot me atë shpenzim vjen 75 euro e kjo është rritje enorme e energjisë elektrike e qmimit e tash shtohet pytja a është kjo njëfar lloj i asaj që qytetarët po harxhojnë më shumë apo ku është problemi prej viteve tjera sepse po flasim për ekonomin familjare e ato zakonisht hargjojnë njejtë po qmimet nëse i krahason përpara privatizimit të KEDS-it edhe tash tregojnë se a mos është shëndrru kjo kompani vetëm për qëllim të përfitimit ekstrem privat e ku qeveria nuk e ka qëllim me e kufizu edhe me e mbajt edhe anën tjetër që është interesi i qytetarit se edhe ne vet këtu jemi konsumatorë e kështu qe krejt këto probleme po dua ti ngris edhe ndoshta na jepni përgjigje më të sakta se edhe vetë këtu raporti ja fillon me fjalinë e parë ku thotë se ‘më 8 maj është bërë përmbyllja e suksesshme e projektit të privatizimit’ e një fjali më poshtë thotë ‘në mënyrë që të arrihen sukseset duhet bërë akoma’ d.m.th tash a është e suksesshme a na duhet ende që të jetë e suksesshme.

Besim Beqaj, theksoi se meqense ne para vetes e kemi analizën e postprivatizimit dhe funksionimit nuk e kemi analizën e privatizimit por meqense unë kam qenë pjesë dhe u ngrit e ndjej të obligueshme që ta jep një shpjegim sepse po keqpërdoret shumë shpesh fjala publike pa asnjë lloj qasje profesionale e as korrekte e kështu mendoj që këto tema nuk duhet të trajtohen mbi bazën e rrëfimeve por mbi bazën e fakteve dhe po ia nisim nga ajo qështja e punëtorëve. Punëtorët kur është bërë privatizimi, me sindikatën e KEDS-it me ndërmjetësimin e ministrisë së punës ne jemi takuar si komitet i privatizimit me ta dhe na janë falënderuar publikisht për

avancimet që i kemi bërë në nivel të kontratave edhe e kanë shpjegju shumë herë por po e ndi të obligueshme edhe një herë ta them këtu. Kontratat që kanë qenë 1-mujore pra kontrata afat shkurtër janë shëndrruar në kontrata 3 vjeqare dhe ky është një avancim për qka kemi marr falënderime nga sindikatat e KEDS-it pra krejt punorët që janë punësu për 1 muaj e kanë vazhduar për 3 vjet ndërsa ata që kanë qenë të përhershëm e kanë vazhdu kontratën e përhershme dhe ju nënshtrohen të gjitha ligjeve të Kosovës. Nuk ka ansjë bazë as juridike as faktografike që këtu privatizimi ka bërë dëm dhe po ju ftoj edhe publikisht deputetëve edhe punëtorët e sindikatave edhe punëtorëve të KEDS-it që nëse kjo ska qenë kështu marrëveshja duhet të dilet edhe të flitet pra kjo punë nuk është me rrëfime por me kontrata edhe fakte. Sa i përket debatit që është bërë për privatizimin është thënë edhe po e them prap që është si metodologji e përkaktimit edhe të investimeve por edhe kriteret për privatizimin janë të përcaktuara nga rregullatori. Rregullatori para se të ndërhyjë në proces të privatizimit i ka përcaktu kriteret mbi bazën e të cilave do të duhej të bëhej privatizimi dhe besoj që ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë edhe nuk mund të krahasohet fare me privatizimet e vendeve të tjera. Vetëm një element e keni në raport ku thuhet “e drejta e qeverisë për ndërhyrje dhe asetet publike” po e them prap sepse KEDS-i është ndërmarrje e rregulluar dhe rregullatori e ka të drejtën për ndërhyrje në rast se KEDS-i nuk i plotëson kushtet për furnizim publik. Është thënë me marr kompaninë pa kompensim, është keqpërdor kinse janë shit kaq kilometra tela e kaq shtylla por asnjë aset i cili ju ka dhënë KEDS-it në përdorim nuk është aset i cili mund të tjetërsohet pa leje të qeverisë, nuk është aset i cili mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër d.m.th qëllimin primar dhe të vetëm e ka me bërë furnizimin me energji elektrike dhe nuk mund ta ndryshon. Prandaj kur flitni për KEDS-in dhe për privatizim ju kisha ftu mirë të i lexoni dokumentet edhe ta shihni formatin e marrëveshjes dhe ti shohim efektet të cilat i kemi para vetes. Ajo që është jashtëzakonisht e rëndësishme është se qmimin nuk e përcakton as KEDS-i as KEK-u sespe kemi me pas edhe furnitor tjer tash me liberalizim të tregut kemi pra furnitor të tjerë që do të vinë edhe ata kanë me bërë kërkes sikurse KEDS-i. Unë besoj që ka qenë gabim në qeverit prej pasluftës që së paku çmimi i rrymës nuk është rrit për nivelin e inflacionit vjetor dhe nëse e marrim tash çmimin për njësi edhe ta krahasojmë në Kosovë edhe në vende të tjera nuk krahasohet çmimi fakturë me fakturë, nuk krahasohet çmimi aty ku ngrohen me rrymë edhe aty ku ngrohen me ngrohje qëndrore. Kur doni me bërë krahasim duhet me bërë krahasim i cili është njësi për njësi dhe njësia është çmimi për kilovat orë me qmimin për kilovat orë dhe këto gjana pastaj na përcaktojnë në çfar niveli jemi a është rrit kjo apo jo. Ajo qka më intereson si qytetar dhe si deputet është që të dijë mesatarja e çmimit të inportit të rrymës para privatizimit edhe pas privatizimit si ka rezultuar a na u ka rrit çmimi i inportit të rrymës apo është zvogëluar dhe në rast se KEDS-i është duke e keqpërdorur ju si rregullator duhet të merrni masa dhe ti raportoni kuvendit dhe normalisht duhet të merren masa konform bazave ligjore dhe konform marrveshjes që e kemi.

Rrustem Berisha, potencoi se realisht e kam ngrit unë si çështje sepse kemi dasht të informohemi sa po respektohet implementimi i marrveshjes ose i obligimeve që janë nënshkruar nga të dy palët, sa po respektohen të drejtat e punëtorëve, pastaj cilat janë investimet në rrjetin e energjisë elektrike sepse kemi një problem jashtëzakonisht të madh të rrjeti i energjisë elektrike edhe vende vende ky rrjet paraqet edhe rrezik serioz për qytetarët e Kosovës. Problemin tjetër ka të bëjë me shkyqjet kolektive me arsyetim kinse po zhvillohen disa punime realisht ka dyshime se kjo mund të jetë edhe e ndërlidhur me importin e energjisë elektrike, pastaj fryerja e energjisë elektrike. Çështja tjetër që unë kisha dasht ta potencojë ka të bëjë me punëtorët që kanë punu prej vitit 2013. Ne e kemi këtu përpara një pasqyrë të asaj, por po e shoh këtu në vitin 2016 janë 120

punëtorë që ju ka ndërpre kontrata e punës pa ndonjë arsytim kërkoj me na dhënë ndonjë sqarim ose ndonjë arsytim pse iu ka ndërpre edhe pse ne këtu lartë i pamë që disa e kanë ndërpre vullnetarisht disa kanë dalë në pension por në 2016 po shohim një statistikë dikund 120 që iu ka ndërpre kontrata e punës. Unë e shoh një problem shumë serioz të stabilizimit me energji elektrike që është një problem e ndikon drejtëpërdrejtë tek nxitja e investitorëve edhe tek ambienti për të bërë biznese se nëse nuk ka shkëmbim të energjisë elektrike pasi që vlerësohet që nuk është stabile edhe po ikin investitorët sespe nuk po dojnë me investu ku nuk është një ambient i mirë për biznes. Këto qështje duhet ti kemi parasysh ne si deputet edhe kjo është e drejtë e jona sepse qdo ditë po biem në kontakt me qytetarët e po kanë ankesa. E tha edhe Besim Beqaj për punë të trafos që ndoshta tek investimet që po i bëjnë ata vetë po i marrin si investime të KEDS-it ose që realisht ata po i bëjnë në mënyrë private edhe a ka mundësi me na e shpjegu rreth importit të energjisë elektrike dhe eksportit se qfarë e bëjnë eksportin dhe qfare importin sepse mendoj që ka mundësi dhe ka hapësirë që të bëhet një planifikim shumë më i mirë i importit të energjisë elektrike sepse tash nuk besoj që nuk kemi mundësi të i dimë nevojat për import me bërë një planifikim shumë më të mirë.

Raif Qela, potencoi se u përmend investimi i mundshëm i konsumatorëve dhe llogaritja apo jo nga ana e rregullatorit se a ka investuar operatori apo a është regjistruar ajo si investim. Ma kanë thënë përfaqësuesit e zyrës së rregullatorit të energjisë kur kam qenë në takim lidhur me një prej bizneseve se konsumatorët kur investojnë në rrjet pavarësisht se edhe nëse e marrin KEDS-i si pronë të veten atë atëherë operatorit i llogaritet zero investim pavarësisht se e bënë atë por këtë e bënë vetëm për arsye se KEDS-i detyrohet ta mirëmbajë atë rrjet. Nëse është kështu atëherë për mua është në rregull por sigurisht do ta jap shpjegimin përfaqësuesi i ZRRE-së. E ndërlidhur me këtë është edhe fakti se sa ka ZRRE kompetenca që ta përcaktojë se ku do të zgjerohet rrjeti në mënyrë që ta detyroj operatin të investojë në një fushë p.sh një investitor i cili ka sjell miliona euro këtu dhe i mungon rrjeti që kërkohet qoftë nga konsumatori qoftë nga institucionet shtetërore që të ndërmmarrin masa në mënyrë që të investohet në atë rrjet, sa keni kompetenca edhe a mund ta bëni një gjë të tillë p.sh për nevojat urgjente që të mos ikin biznesmenët që kanë investuar këtu për shkak të mungesës së rrjetit apo për shkak të mungesës së infrastrukturës të detyrohen të tërhiqen prej Kosovës.

Kryetari, tha se këto materiale japin një informacion, mirëpo kanë mundur me qenë më analitike edhe pse raporti i ZRRE-së, është shumë më detal dhe më analitik por ky i Ministrisë është më shumë përshkrues, ka mundur me qenë më shumë analitik. Informatat janë këtu dhe neve në rend të parë sipas ISC-së efektet janë pozitive në zvogëlim të subvencioneve që i ka dhënë Qeveria përpara, dhe sigurisht duhet të vlerësohen dhe analizohen në tërësi. Mund të them se neve na mungon një krahasim i investimeve të planifikuara edhe të realizuara sepse KEDS-si ose Çaliku kur e ka marrë KEDS-in e ka marrë një planë të investimeve tani më të aprovuar të KEK-ut edhe duhet me ditë që KEDS-i nuk investon më aty por është çmimi i rregullatorit që e cakton investimin, por edhe KEK-u po ta kishte do ta kishte të njëjtin plan edhe mos të ishte bërë privatizimi, por neve po na intereson sepse ka shumë përparësi për efektin e investimeve. Cili është investimi, se në çka është investu, çka ka qenë e parapame për investim, çka është investu, këtë duhet me na sqaru pak në mënyrë më të përmbledhur d.m.th na duhet një informatë plotësuese plani i investimeve për pesë vite në këto objekte, cilat janë realizua, e jo vetëm vlerat se kështu neve na del si të rasti i cili na doli në muajin dhjetor intervenimeve ta parapara në dhjetor që ku na dolën se nuk kanë qenë ashtu siç janë prezentuar por në fund do ta shohim. Ne do të

shprehim brengosje se humbjet teknike nuk janë zvogluar me dinamiken e parapame dhe a është kjo pasoj se nuk janë bërë investime me struktura që janë parapa, a është a nuk është se d.m.th se humbje teknike është dashtë me ra 8.5 % , a është problem për shkak se nuk janë bërë investimet që është dashtë me u bërë në dinamikën më të cilën është dashtë me u bërë sepse investimet tani me i marrë për pesë vjet aty vijnë por tek investimet është një çështje tjetër dhe unë nuk pajtohem krejtësisht me juve dhe nuk është si me investu në vitin 2014, 13 milion si në 2016, 23 milion ndoshta më shumë janë 18 milion në 2013 me efekte se 20 milion apo 23 milion në vitin 2018 d.m.th aty është vlera në kohën e parasë që kishin me dhënë ato investime për pesë vite që shtyhen. Prandaj dinamika dhe struktura e investimeve është mjaftë me rëndësi. Veprimet me kohë në investime neve na kanë mungu p.sh 2 milion janë më pakë investime, si kanë thënë ata ka 20 milion por prej planeve që ja kanë pranë rregullatori janë investime të cilat janë realizu vetëm 86%, d.m.th ai ka pas mundësi me investua dhe nuk i ka bërë ato investime. Në këtë drejtim kjo është për brengosje sepse gjysmën e kësaj fature që janë zvoglu e paguan konsumatori gjysmën KEDS-i, duhet me verifiku këtë. Tash është çështja e punëtorëve, ne e kuptuam plotësisht këtë dhe kemi pasur bised të dëgjojmë kur e kemi formu Komisionin Hetimor ka prezentu Ministri, Beqaj dhe është ashtu si po thotë mirëpo tani neve po na del që disa punëtorë kanë qenë atëher nga një muaj kontratë por neve po na del që KEK-u në krahasim me 2013 KEDS-si në fakt ka më pak 452 punëtorë këtu janë pasqyruar shifrat mirëpo kur po e shikojmë me 8 maj 2013 , 2600 tani i ka 2141 po dalin diku 400 ku sigurisht njerzit mund të shkojnë në pension mund të shkojnë andej dhe kjo meriton një analizë dhe me e pa se neve e kemi shumë të vështir me intervenu në Ligjin e Punës, por sipas Gjykatave ka problem edhe me Ligjin e Punës. Pajtohem se nuk mundemi me u interferu aty ata vendosin në bazë të Ligjit të Punës mirëpo edhe me Ligjin e Punës po na dalin telashe sipas Gjykatave. Këto janë disa çështje të cilat unë i kisha thënë dhe tjetra çkyçjet e planifikume. Mendoj se Rregullatori ka ndërmarr masa në dhjetor që kishin nga 70 vende përnjëher ndërprerje të energjisë nga katër orë dhe e ka parë që të gjitha nuk kanë qenë të drejta dhe neve e presim në raportin me detaj lidhur me këtë me masat që janë marrë aty d.m.th është një problem të cilin neve nuk mundemi të tolerojmë ky është një operatorë privat por gjithëher kemi thënë se jep shërbim publik dhe duhet të ju nënshtrohet normave publike. Tjetra është këtu që kisha dashtë pak më shumë një sqarim. Neve shpesh herë këtë kontratë kemi mundur ta lexojmë por se kemi lexuar gjithëher me kujdes por kjo këtu për mua është pak befasi që deri në shtatë vjet ky nuk mund të shes aksione mbas shtatë vjete KEDS-si mundet me shitë kjo është diçka e re për mua, problem që unë nuk e kam kuptu kam menduar që nuk mundet me shit pa lejen e Qeveris as pas shtatë viteve dhe tash mbas shtatë viteve ky po mundet. Është mirë me e sqaruar edhe një çështje ne e dimë se janë transferuar asetet e KEDS-it që kanë qenë për distribuim janë marrë prej ish Elektro Kosovës janë bartë atje, ka dal një mossqarim ku shpesh herë po ceket që tri hidrocentrale të vogla të cilat janë transferu te KEDS-i a mundeni të na jepni sqarime se këto a kanë qenë pjesë të kontratës, ta sqaroni krejt këtë situatë si ka qenë sepse po bëhen spekulime dhe do ishte mirë me e sqaru që opinionin të jetë në dijeni.

Petrit Pepaj, theksoi se së pari tek mesatarja e çmimit të importit se si kanë qenë para privatizimit e si është tani mbas privatizimit. Në vitin 2012 çmimi mesatar ka qenë 75 euro, import ndërsa në vitin 2016 është 47.6 euro, është çmimi mesatar i realizuar i importit sa i përket investimeve që konsumatorët i bëjnë nëpër trafostacione apo në çështje tjera. Po ju them me përgjegjësi që çdo aset të cilin e ka investuar konsumatori ka vleren zero në bazën në investimet të cilat i paraqet KEDS-i dhe këtë ju them me plotë përgjegjësi se nuk ka asnjë përfitim. Në momentin kur një investitor apo një objekt banimi apo kushdo e investon trafostacionin për nevoja të veta a duhet

na me ja kalu at aset distribucionit ku distribucioni merr përgjegjësi për mirëmbajtje në rast të defekteve apo ndonjë prishje të distribucionit neve kemi përgjegjësi apo duhet me ja lënë përgjegjësinë një investitori i cili e ka ndërtu objektin edhe mbas tri vitesh asnjë banor nuk mundesh me e gjet ma, këtu është problemi sepse nëve këtu e kemi pasur problemin këtë vit në breg te diellit tek banesat e tregtisë i cili nuk është përgjigjë në momentin kur trafostacioni u djeg u dashtë rregullatori me ndërhy me kërkua prej KEDS-it jashta të gjitha dhe planëve të mundëshme për mos me lan qytetarin pa rrymë dhe me dërgu në trafostacion tjetër dhe me mbaru punë, asnjë të hyrë kur janë të hyrat e rregullume të cilat përcaktohen me tarifa, dhe janë disa të pa rregullume të cilat distributori gjatë aktivitetit të vet i shfrytëzon shtyllat IPKO-ja , ato kthehen te konsumatori. Çdo pagesë për lidhje të re që është te konsumatorët e amvisërisë, të biznesit në fund të vitit ato të hyra që ka të pa rregullume ju kthehen te gjitha konsumatorëve ku shpërndahen si benifit te 450 mijë konsumatorë të tjerë dhe asnjë cent nuk i lejohet distribucionet me përfitu në të hyrat që janë të pa rregullume. Sa i përket investimeve, ne me kapacitetin tonë njerzor dhe profesional kemi punu dhe kemi shku në terene edhe me ua shiqu investimet. Kur të bëhen planet investive e detyrojmë operatorin shpërndarës që ato plane me i bërë në bashkpunim me Komunën për shkak se Komunat janë të vetmet autoritete që e dinë nevojën që nga kanë mu zgjëru kah ka me pas nevojë për investime edhe kërkujmë dëshmi nga KEDS-i që të dijmë se a ka pas takim me ata kryetarë të Komunave dhe cilat kanë qenë kërkesat e Komunave. Ne vjet e kemi detyruar KEDS-in për me mbajtë një diskutim publik ku kanë qenë të ftuar të gjithë kryetarët e Komunave dhe është prezentuar master plani 10 vjeçar d.m.th në momentin kur të sigurohemi që KEDS-i i ka bërë të gjitha përpjekjet me kryetarët e Komunave dhe përfaqësuesit e Komunave që janë bërë investimet dhe dakordohen që investimet që janë të parapara janë në përputhëshmëri me energjinë. Vetëm në atë mënyrë neve e bëjmë aprovimin e investimeve, dhe çdo devijim të cilin KEDS-i mundet me bërë në investime nuk mundet me bërë në rast se nuk e merr lejen nga Rregullatori i Energjisë, në rast se KEDS-i e bënë pa lejen e rregullatorit ai investim nuk i numrohet në të hyra maksimale, pra kjo është ajo çasje që bëhet. Çasja është që kur është aprovuar plani zhvillimor 2012-2017, kemi filluar nga ai parim që së pari mu eliminu fytet e ngushta ku ka linja dhe ku rrezikohet siguria publike. Ku do të duhet të përmirsohet kualitetit i furnizimit, këtu kanë qenë të fokusuar sidomos te furnizimi i pikës matëse, d.m.th me përmirësimin e pikës matëse kemi nënkuptuar që me zëvendësimin e njehsorëve në kufirin KEK-KOST, do të bëhet matja e saktë dhe do të dihet saktë për shkak se ka pasur me u bë një privatizim dhe dihet se sa energji ka dal prej gjenerimit, sa ka qenë niveli i shpërndarjes dhe i transmetimit. Ju e dini se Qeveria para privatizimit atëherë ka ndrruar edhe nivelin e tensionit ku pjesën e 110 kë ka kaluar në pronësi shtetore dhe kjo ka qenë ajo e mira që KEDS-i u detyru me vendos pika matëse, njehësor të menqur të cilët e masin energjinë elektrike në çdo sekond. Te humbjet pavarsisht përmirësimit që është bërë humbjet e energjisë elektrike janë humbje e të gjithëve edhe të Institucioneve të vendit edhe neve si qytetarë. Edhe nëse nuk e kemi një dakordim tonin të përbashkët që ai që e vjedh energjinë elektrike është duke na e vjedhur të gjithëve dhe atë vjedhje duhet me e ndal duke filluar nga gjykatat dhe me i përshpejtu të gjitha procedurat e mundëshme por edhe KEDS-i me e përcjell me përpikëri çdo procedur që e ka të mundëshme çdo veprim që duhet me e bërë në raport me konsumatorin. Sa i përket ndërprerjeve që u përmend prej shumicës prej jush deputetë, ai është një raport i veçantë jashtë këtij raporti d.m.th ne e kemi investigu dhe e kemi monitoru në mënyrë të përafërt kemi parë që ka pas mos koordinim, ka pas mospërputhje ndërmjet lëndëve që i ka publiku dhe atyre që i ka realizu. Nuk mundem me thënë që gjithqka ka qenë keq ka pas mirëmbajtje që është bërë por ka pas edhe vende që e kemi konstatuar që nuk ka pas, ai proces është në proces të respektimit të procedurave ligjore që kemi dhe jemi në pritje të rezultateve

finale të KEDS-it në lidhje me të gjeturat të cilat neve i kemi konstatuar dhe i kemi në raport dhe jemi në pritje dhe besoj që në mbledhjen e fundit të bordit të ZRRE-së, do të vendos se çfarë mase merr mbi bazën e konstatimeve që i kemi paraqit si ekspert të ZRRE-së, fjala është për ndërprerjet e muajit tetor –nëntor. Te importi, pyetja a mos ka impakt importi në këto reduktime, ne e kemi dorëzuar një raport për çdo orë për çdo ditë, për çdo muaj me e pa se sa ka pasur import dhe me e konceptuar. Nuk i lejohet kompanisë në asnjë rrethanë që në të njëjtën kohë me pas reduktime të energjisë elektrike dhe me eksportu, ajo është shkelje, mundet me pas të njëjtën kohë import dhe reduktim në të njëjtën kohë është shumë e vërtetë për shkak se plani për një vit bëhet përmes bilancit elektroenergjetik. Çështja e raportit punëdhënës dhe punëmarrës nuk është çështje e ZRRE-së. Sa i përket rritjes së çmimeve në vitin 2012 ka pa pas një rritje nuk ka qenë e privatizime në atë kohë por ka qenë Korporata Elektro Energjetike e Kosovës, në vitin 2013 nuk ka pasur ngritje, prej 2008-2012 nuk ka pasur ngritje fare, në vitin 2013 ka qenë 0, në 2014 ju e dini për shkak të aksidentit ka qenë e domosdoshme rritja .

Kryetari, pyeti se sa janë rritë çmimet prej se është privatizuar, me vendim të rregullatorit?

Petrit Pepaj, sqaroi se çmimi mesatar ka lëvizur prej 5.2 në 5.4 nëse nuk e gabojmë mos të kapem tani për shifra sepse nuk e kam shumë të qartë por nëse e krahasojmë me rajonin në statistikat e mundshme Kosova është vendi me çmimin më të lirë në regjion dhe nuk ka vend që ka çmimin më të lirë për kilovator sa e ka Kosova, po flas me të dhënat zyrtare që i publikon rregullatori që janë të Evropës Eurostatit çdo publikim që e bënë në çdo institucion që e shihni Kosova e ka çmimin më të ulët të energjisë elektrike.

Raif Qela, sqaroi se kamë thënë se edhe ju e keni aprovuar se ka pasur devijime nga kontrata në dinamiken e realizimit të investimeve dhe nëse ka pas, a kanë qenë ato vetëm justifikime të operatorit që kinse nuk paskan marrë leje prej Komunave tjera apo ka pas mundësi që ato investime të parapara të qohen diku tjetër dhe me këtë të përmbushet kontrata dhe nëse nuk është realizuar kjo a keni ndërmarr ju si Rregullator ndëshkim për operatorin.

Petrit Pepaj, u përgjigj se çdo devijim që del prej kësaj duhet me marrë një leje prej Rregullatorit, neve kemi biseduar me kompaninë dhe kemi kërkuar se cilat janë arsyet për shtyrje të projekteve, ata na kanë shpjeguar dhe na kanë treguar që problemin më të madh që hasin e kanë të marrja e lejeve për me kaluar nëpër prona të njerzëve rreth shtëpive të njerzëve. Pyetja se a mundësh një investim që është parapara për përforsim të rrjetit me e dërgu diku tjetër kjo ndoshta është çështje që mundemi me diskutu por nuk ka pas ndonjë kërkesë të tillë për shkak se këto investime duhet me u krye sepse janë parapara këtu për me u krye por për periudhën 5 vjeqare jamë i bindur se këta janë gati me arritë. Nëse ka filluar një projekt për arsye të ndryshme në muajin e dytë apo të tretë ai projekt është ndal, ai projekt nuk mundet me u destinu diku tjetër për arsye se në vitin tjetër mundet me u bart, për me u ridestinu nuk mundet sepse nuk lejohet. Çmimi i eksportit i realizuar në vitin 2016 është 29.7 euro, ndërsa sa i përket zgjerimit të rrjetit d.m.th a kemi autoritet na me i detyru kompanit për me e zgjeru është Ligji për Energjin Elektrike mos gabofsha është një Nen aty që thotë, që kompania nuk duhet me bërë investime në rast se nuk ka rrjet ekzistues duhet investitori me shpenzimet e veta me e zgjeru rrjetin jo kompania. Ajo është e përcaktuar me Ligj por neve e kemi një autoritet që në metodologjinë e taksave për kyçe mundemi me vendos kushte specifike për operatorin e sistemit të shpërndarjes që për raste të caktuar për një biznes të caktuar me kriju lehtësira dhe ato të hyra sa ti merr prej atij investimi me ju rikthi konsumatorit, kjo është

krejt qasja se si dojnë me e trajtu a dojmë me trajtu që të gjithë me investu për të ardhmën apo dojmë që për një investim me pagu 450 mijë konsumator kjo është çështje të cilën duhet me e diskutu dhe nuk është fare e lehtë pra është debat se si do vendosim. Lidhur me transferimin e aseteve është kusht Ligjor që në momentin kur një kompani ndryshon kontrollin prej një kompanie publike në një kompani private duhet me bërë kërkes te ZRRE-ja për ndryshim të kontrollit. Në të njëjtën kohë duhet për me bërë kërkes edhe për transferim të licencave dhe për tjetërsim të aseteve prej pronës publike në pronë private. Asetet distributive, HC distributive, ashtu dhe janë quajtur kanë qenë në asetet e distribucionit edhe janë transferu me transferimin e licencave te KEDS-i, dhe ato janë asete të dhëna me konsension me një marrveshje për qira për shfrytëzim. KEK-u ja ka dhënë operatorëve privat që i kanë marrë për me investu, KEK-u ja ka dhënë operatorëve privat në shfrytëzim përmes një procedure që ka qenë në atë kohë.

Nazmi Zenelaj sekretar i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, theksoi se janë dy elemente që i konstatoi Petriti, çështja ligjore dhe çështja e statusit. Çështja Ligjore paraprake është që kanë qenë pjesë distributive e KEDS-it në kohën kur ka qenë koorporata si tërësi e KEK-ut që janë destinu për çështje distributive dhe ato janë koncesionu nga KEK-u përmes autoritetit të ZRRE-së dhe kanë një marrdhënie kontraktuale koncesionale në afat të caktuar, dhe mbas përfundimit të kontratës kjo vendoset prap në diskutim në mes këtyre autoriteteve se në rast se kthehet në pronësi kthehet pa efekte distributive.

Besim Beqaj, sqaroi se çështja e shthurjes së KEK-ut me KEDS-in është bërë para procesit të privatizimit HC-të distributive janë asete të distribucionit para privatizimit, nuk kanë hyrë në privatizim dhe si të tilla ato janë dhënë nga KEK-u përmes rregullatorit në konsension privat i cili vazhdon me qenë 20 apo 30 vjet pra ato për momentin nuk i ka KEDS-i në shfrytëzim, i ka koncesionari i cili me përfundim të kontratës duhet me u marrë vesh me rregullatorin për transferin e tyre në fazën tjetër. Duhet të thuhet edhe një çështje sa i përket kësaj sepse ne proces të privatizimit në përjashtim të dy kontratave që është marrveshja për shitblerje të aksioneve, marrëveshja për implementim janë marrveshje të cilat janë nënshkrua në mes të Qeverisë dhe në këtë rast privatizuesit, ndërsa të gjitha kontratat tjera të gjitha marrveshjet për transfer dhe të gjitha kontratat tjera janë bërë në mes të KEK-ut dhe KEDS-it pra janë punë profesionale të KEK-ut dhe KEDS-it dhe dy gjanave që na kanë ardhë neve atëher dhe është marrë vendim pozitiv që na kanë ardhë nga KEK-u dhe KEDS-i kanë qenë qendra e trajnimeve që ka qenë pronë e distribucionit dhe 110 kë të cilat me regjistër kanë qenë pronë e distribucionit. Sa ka qenë shtetror ne kemi marrë vendim me mbet në KEK me mbet në interes publik dhe njëkosisht edhe qendra për trajnime është hjek nga lista e aseteve dhe është shku në drejtim të KEK-ut që me mbet në këtë rast publik, pra kjo është shpjegimi sepse është manipulu shumë.

Kryetari, ta kem këtë sqarim të kuart d.m.th KEK-u para privatizimit i ka dhënë me koncesion këto tri hidrocentrale kjo është mjaftë me rëndësi i ka dhënë me vendim të rregullatorit e tash a ka qenë kjo në harmoni me ligje sepse për koncesione në privatizim duhet me vendos Qeveria ose Kuvendi e jo me vendos KEK-u sa i dimë ligjet.

Petrit Pepaj, e di që Rregullatori nuk ka autoritet me dhënë asnjë vendim për koncesion për askënd. KEK-u e ka bërë mbi bazën e procedurës Ligjit për tenderin që ka qenë në atë kohë dhe i ka dhënë me koncesion operatorëve të cilët kanë qenë më të përgjegjshëm të cilët i kanë ofru edhe ofertat më të mira për investime për me mujt me i fut në funksion ato hidrocentrale.

Rregullatori nuk ka vendim, vendimi është vetëm për transferin e aseteve prej KEK-ut tek KEDS-i dhe asgjë tjetër.

Besim Beqaj, vetëm edhe një qartësim Petrit, Rregullatori nuk merr përgjegjësi me krijë raporte aktuale në mes të subjekteve ekonomike por rregullatori aprovon kalimin e të drejtës nga një subjekt në subjektin tjetër mbi bazën e marrëveshjes që ka ekzistuar përpara.

Kryetari, theksoi se ishte mirë që e diskutuam dhe i sqaruam disa gjëra, kanë mbet edhe shumë çështje tjera është fakt që pajtohem se ne e kemi çmimin më të lirë të energjisë mirëpo duhet të kemi parasysh sepse energjia te ne prodhohet me kapacitete të vjetërme ku amortizimi është zero për atë shpenzimet e prodhimit bëhen më të vogla, se kur të vie ky operatori i ri kur të bëhet amortizimi i lartë atëherë të ardhurat e lejuara do të ngriten dhe çmimi do të ngritet prandaj nuk është kjo që është një situatë specifike e Kosovës. Ne duhet të shohim, edhe ne kërkojmë nga ju kur të vie raporti në qoftë se çmimi mesatar i furnizimit KEDS me import me krejt del diku 29 euro e konsumatori paguan diku 70 euro d.m.th tri herë po rritet vlera e kësaj, aty janë humbjet ineffiçenca, mirëpo ne duhet me bërë një vlersim edhe më kritik. E dyta tek KEDS-i, sa është fitimi i KEDS-it, fitimi i planifikuar i lejuar i KEDS-it sa përqind fiton KEDS-i?

Petrit Pepaj, u përgjigj se fitimi i lejuar për KEDS-in është 12% në shitje.

Pas debatit, Komisioni, nxori këto:

Konkluzione

1. *Ministra e Zhvillimit Ekonomik dhe Zyra e Rregullatorit për Energji të forcojnë mbikqyrjen e zbatimit të kontratës së Privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike – KKDFE (KEDS);*

2. *ZRRE në raportin vjetor për vitin 2016 të sqarojë në detaje humbjet e energjisë elektrike dhe vlerën e energjisë elektrike nga importi dhe prodhuesi deri te konsumatori i fundit;*

3. *ZRRE të procedojë sa më shpejtë raportin mbi ndërprejet e energjisë elektrike gjatë dhjetorit 2016.*

4. Shqyrtimi i Raportit për Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari – Kryetari, tha se asnjë Komision i përhershëm nuk ka paraqitur ndonjë koment apo vërejtje përveç Komisionit për Legjislacion, i cili ka rekomanduar që ti ndrrohet titulli i projektligjit sepse projektligji ka pësuar edhe një herë ndryshim dhe plotësim dhe kjo duhet të evidentohet në titull të projektligjit. Ku kërkoj që ky rekomandim të aprovohet nga Komisioni.

Komisioni e aprovoj rekomandimin e Komisionit për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

a) Letra e Kryesisë së Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së sindikatës së NPQ Posta e Kosovës

Kryetari, njoftoi se kemi marrë një letër nga Kryesia e Kuvendit, e cila na ngarkon neve Komisionin për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri që ta shqyrtojë kërkesën e sindikatës së punëtorëve të NPQ Posta e Kosovës, si dhe peticionin e punëtorëve të kësaj organizate lidhur me vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe, Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqes raportin me rekomandime lidhur me këtë çështje. Ne e kemi trajtuar këtë çështje para se me ardhë kjo kërkesë, menjëherë kur na e ka dërguar drejtori i Postës. Ne kemi konsultuar shërbimin juridik të Kuvendit se ku është mundësia jonë e intervenimit. Mundësia jonë është me diskutuar por çështja tani është në gjykatë dhe në smund të ndërhyjmë në vendimet e Autoritetit e as të gjykatës. Ne kemi kërkuar prej Autoritetit konkurrencës që ta shtyjë aplikimin e këtij vendimi derisa të vendos Gjykata. Ne duhet ta informojmë kryesinë me këtë diskutim që e kemi pasë dhe shpreh mendimin që është shumë delikate ne tash me hy me vlerësuar ose me anuluar vendimet e Autoritetit, por në përgjithësi mendoj se ka gjasa Gjykata me i shqyrtuar ato zbrazësi që janë edhe do të shohim çka do të vendos Gjykata.

Besim Beqaj, tha se ju e dini që kam qenë kundër kësaj përbërje të bordit të konkurrencës, sepse kam konsideruar se kanë qenë jo profesional dhe po dëshmohej që janë joprofesional. Vendimet e tilla duhet të merren me shumë kompetencë dhe me analizë. Ata kanë hapësirë shumë më shumë me trajtuar çështjen e konkurrencës mes subjekteve tjera e jo që në fillim me ndërmarrjen publike e cila ka shumë njerëz të angazhuar. Unë nuk e di që nuk jam jurist dhe do ta kisha trajtuar këtë si çështje që Kuvendi me i thirr në përgjegjësi sepse bordi i përgjigjet Kuvendit, Komisioni për konkurrencë i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ata është mirë me na dhënë një shpjegim neve, edhe pse jo, unë mendoj që ato borde që i cakton kuvendi të nisë edhe procedurën e shkarkimit në rast se konstatohen se ka çfarëdo lloj shkelje apo çfarëdo lloj abuzimi, sepse këtu jemi duke folur për interes publik për ndërmarrje publike dhe nëse ne shkojmë i lëmë krejt ndërmarrjet tjera që kanë konkurrueshmëri me pikëpyetje shumë më të madhe, shkojmë e ngjitemi te një Postë e cila ka probleme financiare, sepse shtetet në kushte normale shërbimet postare edhe i subvencionojnë, i përkrah shteti. Prandaj në këtë drejtim unë jam që ne ti thërrasim në një takim ata le të na shpjegojnë, që na të shohim mundësitë ligjore që ne pas verifikimit të vendimit të tyre pse jo edhe me i shkarkuar.

Raif Qela, theksoi se sado që ky Autoritet si edhe institucionet tjera të pavarura duhet ta kenë pavarësinë e plotë nga ndërhyrjet politike, megjithatë këto institucione nuk mund të jenë krejtësisht të pavarura nga kushdo qoftë. Kuvendi është organi i cili duhet të mbikëqyrë punën e tyre dhe unë ashtu si edhe parafolësi jam i bindur se nuk janë duke e kryer detyrën në përputhje me atë se si është dashur ta kryejnë. Ka ngecje të mëdha në punën e tyre, ka mungesë për bindjen time edhe mungesë profesionalizmi por mund të jetë edhe mungesë e guximit për të marrë vendime të vështira sepse nuk i kanë kryer disa detyra që është dashur t'i kryejnë shumë shpejtë edhe janë kapur pas një ndërmarrje publike e cila edhe ashtu nuk i ka punët mirë. Prandaj, edhe unë them që ata të japin përgjegjësi për këtë para Kuvendit, se a do të bëhet kjo përmes Komisionit apo të bëhet para Kuvendit ata duhet të raportojnë lidhur me këtë problem të krijuar, edhe pse qenka hequr ajo procedurë përpara, të kthehet ajo procedurë sepse është krejt normale, nuk mund të ketë institucion krejtësisht të pavarur prej të gjithëve, Kuvendi është institucioni i cili mbikëqyrë Agjencitë edhe institucionet e pavarura.

Kryetari, potencoi se ata janë përgjegjës me zbatuar ligjin, nëse e kanë shkelë ligjin atëherë e konstaton gjykata, edhe atëherë ne mund të flasim për përgjegjësi. Natyrisht që neve nuk na ka ardh mirë që ka marrë vendim rreth Postes. I kemi thirrë dy palët edhe kjo çështje është në shqyrtim nga Gjykata. Kur ta sjellin raportin vjetor ne mund t'i thërrasim ata, në raport e shohim çka kanë punuar, cilat punë i kanë bërë për një vit, ata që një vit janë aty, shohim çfarë punë kanë bërë për një vit edhe ne nxjerrim konkluzionet e caktuara.

Sala Berisha-Shala, theksoi se meqenëse ky komision është që monitoron punën e shtatë agjencioneve të pavarura përfshirë edhe Autoritetin e konkurrencës, por në këtë Komision raporton edhe njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike që është te Ministria e zhvillimit ekonomik, natyrisht që ky komision e ka obligim me pa edhe performancën e ndërmarrjeve publike në këtë rast të Postës. Mendoj që pavarësisht ku është procedura e kësaj çështje nuk ka kurrgjë të keqe që ne si Komision ta ftojme thjesht edhe Autoritetin e konkurrencës por edhe Njësinë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, por edhe menaxhmentin e Postës edhe të shohim, t'i ballafaqojmë të tria këto në lidhje me problematikën dhe besoj që nuk do të reflekton, nuk ndikon në përfundimin e procesit që është në Gjykatë por thjesht ne si deputet të njoftohemi më për afërsisht se si është situata, si është gjendja, ti marrim informacionet më detale dhe këto informacione besoj që do ti kemi të plota në rastin kur të triat ballafaqohen para Komisionit. Ka pasë edhe raste tjera kur ne si Komision në mandatet e kaluara i kemi ftuar drejtorët e menaxhmentit siq është rasti të KEK-ut, Trepçës, etj, po edhe të Postës e kemi pasë këtu shumë më herët, do të thotë mandatet e kaluara. Ndjehemi të obliguar thjesht me pasë një kuartesi, për hiq gjë së paku për veti me ditë sepse për çdo ditë po ballafaqohemi edhe me media edhe me gazetarë se si është ai problem, se si është ky problem. Personalisht nuk po di se çka me ju thënë, është e vërtetë që ne nuk kemi të drejtë me ndërhy në vendimet e institucioneve të pavarura as në ndërmarrjet publike por së paku me dit realisht se si është situata.

Kryetari, sqaroi se sa i përket kësaj Njesisë për ndërmarrjet publike, kjo njësi është shumë duke u vonuar, ne nuk e kemi as raportin e 2015-tës, praktikisht ajo njësi nuk besoj që ka me na ndihmuar ndonjë gjë. Kjo situatë, mendimi im është që na do ta trajtojmë këtë me raportin që do ta marrim shpejtë, raportin e punës së tyre. Tash për tash vendimin e ka suspendu Autoriteti derisa të kryhet rasti në Gjykatë. Propozoj që ta trajtojmë me raportin dhe ta shohim çka kanë bërë. Pajtohem që askush nuk ka amnisti me shkelë ligjin, nëse e kanë shkelë ligjin shkojnë në

përgjegjësi, edhe natyrisht i shohim për një vjet çka kanë bërë a kanë bërë vetëm këtë punë apo kanë bërë edhe punë tjetër, do t'i analizojmë. Natyrisht që ne kërkojmë përgjegjësi prej secilit. Ne e njoftojmë kryesin se në prill do ta shqyrtojmë raportin e autoritetit, se vendimi është suspenduar dhe rasti është në Gjykatë.

Besim Beqaj, propozoj që ti thërrasim javën e ardhshme në mbledhje, vetëm për këtë temë edhe të na njoftojnë, të diskutojmë për këtë çështje. Ne po duam të informohemi, dhe kisha kërkuar që ta qesim si propozim në votim nëse pajtohem mirë nëse nuk pajtohem nuk ka problem. Potencoi se nëse ne kemi kërkesë prej Kryesisë së Kuvendit me trajtuar, dhe ne së paku të marrim një hap për me i thirrë në një seancë dëgjimore, kurrëgjë tjetër, unë po propozoj që me fut në votim nëse ne pajtohem.

Kryetari, theksoi se po pajtohem që ata të na dërgojnë një informatë, mandej ne në mbledhjen sot një javë vendosim a kemi nevojë t'i thërrasim apo jo. Edhe kjo varet përafërsisht kur na vjen raporti i punës i tyre. Mendoj që kjo situatë, ky vendim është ndalë, nuk është duke u zbatuar. Ne nuk jemi ndarë në asnjë mbledhje nuk po ndahemi as tash ne jemi si komision edhe veprojmë pa presion.

Blerim Grainca, tha se është mirë që për tema të kësaj natyre të kemi një koncensus, ndoshta nuk është aq e ngutshme një procedurë teknike të futet në votim, kjo është shumë teknikallitet, ne do ti thërrasim a nesër a pasnesër.

Pas debatit Komisioni nxorri këtë:

Konkluzion

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të informojë me shkrim Komisionin deri më 20 mars 2017, për vendimin e tij nr.41/16 të datës 06.12.2016 lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Postës së Kosovës Sh.A. dhe disa institucioneve publike dhe pas analizës së informatës të ftohen në raportim në Komision.

b) Njoftim për tryezën me 20 mars 2017

Sala Berisha-Shala njoftoi anëtarët e Komisionit se kemi përfunduar draftin e projektligjit për miniera dhe minerale dhe INDEP-i ka organizuar një tryezë për diskutim të draftit të projektligjit për miniera dhe minerale ku kjo tryezë do e këtë rolin e dëgjimit publik. Tryeza është me 20 mars ora 13:00 në ORION, dhe ju ftojme të gjithë deputetëve të Komisionit të merrni pjesë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa